



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5261 prot.

Ballsh, më 02.11.2023

VENDIM

Nr. 51 Datë 30/10/2023

**MBI MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS, PLANIT TË KONSULTIMEVE DHE
PLANIT TË BUXHETIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR PËR VITIN
2024**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak,

VENDOSI

1. Planin e Aktivitetit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2024:
 - a) Plani i Punës të Këshillit Bashkisë për vitin 2024.
 - b) Plani i Konsultimeve të Këshillit Bashkisë për vitin 2024.
 - c) Plani vjetor i buxhetit për vitin 2024.
2. Pas miratimit Plani i Aktivitetit të vitit 2024, do të zbatohet nga Këshilli Bashkiak Mallakastër.
3. Ky vendim shoqërohet me programin e çështjeve të parashikuara sipas muajve për vitin 2024.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

